

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIRO KASTËR
SENATI AKADEMIK

Nr. 123/2 Prot

Datë 02/02 2021

VENDIM

Nr. 05 , datë 02.02. 2021

**PËR
NGRITJEN E QËNDRËS NDËRDISIPLINORE TË KËRKIMIT DHE ZHVILLIMIT**

Në zbatim të ligjit 80/2015 " Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" nenet 27 "Qëndrat studimore ndërdisiplinore"; të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, neni 13 dhe në vendimin Rektoratit nr. 01 datë 01.02.2021, Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 02.02.2021,

V E N D O S I

Të miratojë:

1. Krijimin e Qendrës Ndërdisiplinore të Kërkimit dhe Zhvillimit (QNKZH), me vartësi nga Rektorati.
2. QNKZH e shtrin veprimtarinë në rang institucioni.
3. QNKZH përbëhet nga 9 (nëntë) anëtarë personel akademik me kohë të plotë, nga tre për secilën njësi kryesore të UGJ-së.
4. Anëtarët e QNKZH propozohen nga njësitë kryesore dhe miratohen nga Rektorati.
5. Anëtarët e QNKZH duhet të kenë gradë ose titull shkencor.
6. QNKZH si njësi nuk përfshihet në funksion të përmbushjes së standarteve institucionale të UGJ-së.

Adresa: Lagjia "18 Shtatori", Rruga "Studenti", Gjirokastrë, Tel: 842-6146, 63408, Fax: 842- 637776, web: uogj.edu.al, email: rektori@uogj.edu.al

7. QNKZH ka për qëllim që përmes veprimtarive kërkimore shkencore ndërdisiplinore të kontrboj në zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë rajonale dhe ndërkufitare në fushat e:
- agroturizmit;
 - trashëgimisë kulturore dhe historike;
 - ekoturizmit.
8. Pjesë e realizimit të veprimtarive kërkimore-shkencore të zhvillimit rajonal e ndërkufitar të jenë edhe studentët e UGJ-së.
9. Projektet e kërkimit dhe zhvillimit të jenë të integruara me universitete e institucione të tjera ndërkufitare.
10. Anëtarët e QNKZH në mbledhjen e parë zgjedhin nga radhët e tyre përgjegjsin dhe sekretarin, të cilët miratohen nga rektori.
11. QNKZH në mbledhjen pasuese ngre grupin e punës për hartimin e rregullores së funksionimit të saj, e cila, pas hartimit i përcillet Senatit Akademik për miratim.
12. Për veprimtarinë e kryer në përputhje me qëllimin QNKZH raporton periodikisht në Rektorat.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i përcillet:

- Zv/rektorit për kërkimin shkencor dhe marrëdhënjet me jashtë;
- Dekanëve.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof.dr.Bekfash MEMA

